



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Datë: 12.22.2017

Duke u bazuar ne KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS neni 119 par.3 dhe 7, **nenit** 28 par. 1.8 të LIGJIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS, Nr. 03/L-229, Gazeta Zyrtare nr. 88/ 25 nëntor 2010, si dhe LIGJIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-229 PËR MBROJTJËN E KONKURRENCËS Nr. 04/L-226, Gazeta Zyrtare Nr. 17/10 mars 2014, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, ne mbledhjen e mbajtur me 12.22.2017 bjen këtë:

MENDIM PROFESIONAL

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës** gjatë analizimit të DRAFT-UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE vëren se neni 3 par. 2, neni 6, 7 dhe 20 par. 2 dhe 3 bien ndesh me Ligjin Nr. 03/L-229 për MBROJTJEN E KONKURRENCËS, konkretisht me Nenin 2, Nenin 4 paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.4.
- II. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës** rekomandon Ministrinë e Infrastrukturës që ta **rishikoj** dhe ta bëjë plotësim ndryshimin e dispozitave në DRAFT-UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE veçanërisht nenin 3, 6, 7 dhe 20.
- III. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës** Sugjeron - që Autoriteti Homologues (Ministria) të bëjë Liberalizimin e tregut të Homologimit të automjeteve, ta hap tregun në më shumë subjekte afariste duke u bazuar në një konkurrencë të lirë dhe të ndershme të tregut.
- IV. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomandon** Ministrinë e Infrastrukturës që në parim, tregu i lirë e përcakton çmimin e shërbimit të Homologimit, meqë rasti karakterizohet si specifik, atëherë Ministria vendos vetëm për çmimin tavan - maksimal duke mos i detyruar subjektet e autorizuara të kenë çmime unike.

ARSYETIM

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për vlerësimin ex-ante të DRAFT-UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE, është vënë në funksion pas shqetësimeve të opinionit publik me pretendimin se i njëjti është në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Autoriteti Kosovar i

Konkurrencës me tutje ref. si Autoriteti, ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe ka analizuar DRAFT-UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE.

Përcaktimi i Tregut Relevant

- Tregu Gjeografik

Duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për Mënyrën dhe Kriteret e Përcaktimit të Tregut Përkatës, Nr. 02/2011, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet *territori i Republikës së Kosovës*.

- Tregu i Produktit:

Konsiderohet, shërbimet e *Homologimit të Automjeteve*

Liberalizimi i tregut

Autoriteti, sugjeron se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve të cilët janë potencial për tu angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) është e pa dëshirueshme me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, që konkurrentët /operatorët të mos kufizohen nëpërmjet kushteve dhe kriterëve, sepse për të pasur konkurrencë të mirëfilltë duhet që të ketë më shumë konkurrent në tregun relevant.

1. **Neni 3 par. 2** i DRAFT-UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE, shpie në sjellje anti konkurruese, sepse Autoriteti homologues (Ministria), gjithëherë është duke folur në numrin *Njejës*, gjë që po e kufizon mundësinë e dhënjës së autorizimit në me shumë se një operatorë dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, konsideron se ndërmarrjet të cila autorizohen nga Autoriteti homologues (Ministria) për ofrimin e shërbimeve të homologimit janë *subjektet e autorizuar afariste*, (shih LIGJIN Nr. 05/L-132 për automjete Neni 16).
2. DRAFT-UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kërkon, që ku përmendet "subjekt i autorizuar", të ndryshohet me *Subjektet e Autorizuara Afariste*.

Andaj :

Neni 3 par. 2 është si në vijim:

Autoriteti homologues (këtu e tutje Ministria) autorizon subjektin e autorizuar për të gjitha aspektet e homologimit: të tipit te mjetit, sistemeve të tij.....

Autoriteti i Konkurrencës, rekomandon që të ndryshohet në këtë form:

Autoriteti homologues (këtu e tutje Ministria) autorizon subjektet e autorizuar afariste për të gjitha aspektet e homologimit: të tipit te mjetit, sistemeve të tij.....

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, rekomandon që të shtohet paragrafi 4 (i RI) te neni 3 i Draft-Udhëzimit Administrative si në vijim:

“Dhënja e Autorizimeve për kryerjen e shërbimit të homologimit tek subjektet e autorizuar afariste, Autoriteti homologues (Ministria) autorizon të gjithë ata që i plotësojnë kushtet për operimin profesional”.

3. **Neni 6** para. 2 i DRAFT-UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomand Ministrinë e Infrastrukturës, që ta rishikojë para.2 të nenit 6 në tërësi duke mos rënë në kundërshtim me neni 4 par. 1.4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës citoi *“zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese”.*

Po ashtu,

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, rekomandon Ministrinë e Infrastrukturës që paragrafi 1 të neni 6 ta riformuloi si në vijim:

1. *Ministria përcakton kushtet për funksionim profesional të institucioneve të autorizuar kompetente me kapacitete të mjaftueshme për homologimin e mjeteve sipas standardeve nderkombetare teknike per kryerjen e shërbimit te homologimit.*

4. **Neni 7** i UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE, Autoriteti homologues (Ministria) me këtë nen të ketij Draft - Udhëzimi Administrativ *apriori prejudikon* se vetëm njëri nga subjektet afariste i plotëson kushtet për ofrimin e shërbimeve të Homologimit. Si e tillë shpie në sjellje anti-konkurruese përkatësisht bie ndesh me Ligjin per Mbrojtjen e Konkurrencës neni 4 paragrafi 1.4. duke i vendosur ndërmarrjet tjera në pozita të pafavorshme konkurruese.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomandon që neni 7 i ketij udhëzimi administrativ të riformulohet në tërësi sepse ka *ambiguitet dhe i vendos ndërmarrjet tjera në pozita të pafavorshme konkurruese.*

5. **Neni 20 par. 2 dhe 3** i UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MI) Nr. Xx/2017 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR HOMOLOGIM TË MJETEVE RRUGORE, shpie në sjellje anti konkurruese, sepse Autoriteti homologues (Ministria), është duke e përcaktuar dhe kufizuar çmimin. Me këtë form po shkelet paragrafi 1.1 i nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Çmimet përcaktohen nga tregu i lirë, por në raste specifike Autoritetet mund ta përcaktojnë vetëm çmimin më të lartë apo më të ulët të produktit apo shërbimeve specifike, duke mos i detyruar subjektet e autorizuar të kenë çmime unike.

Neni 20 par. 2 është si në vijim:

2. *Ministria përcakton çmimoren për tarifat e parapara për shërbimet e përcaktuara.*
3. *Tarifat janë unike dhe vlen për të gjithë subjektet e autorizuar.*

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomandon që të ndryshohet në këtë form:

2. *Në parim, tregu i lirë e përcakton çmimin e shërbimit të Homologimit, meqë rasti karakterizohet si specifik, Ministria vendos vetëm për çmimin maksimal - tavan.*
3. *Të fshihet paragrafi 3 i nenit 20 të Udhëzimit Administrativ.*

Autoriteti është në zbatim të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjeve të ndaluara, praktikave të bashkërenduara dhe realizimit të përqendrimeve të paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga **administrata shtetërore dhe entet rregullatorë** në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Mendimi profesional, është marrë nga Autoriteti ekskluzivisht nga këndvështrimi i rregullave që dalin nga Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, për një treg të hapur dhe konkurrues, duke u bazuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 10 “Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës” dhe duke u bazuar në nenin 23 “Dhënia e Mendimit Profesional” të Ligjit nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, me ç’rast përmes këtij rekomandimi i propozon Ministrisë së Infrastrukturës, që të ndërmarr veprime ligjore për amendamentimin e draft udhëzimit administrativ, që rregullon fushën përkatëse.

Me këtë Mendim Profesional, të njoftohet:

- *Ministria e Infrastrukturës*
- *Avokatit të Popullit*
- *Instituti GAP*
- *Arhivës*

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

(_____)
Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)
Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar

(_____)
Fatime Haziri
Anëtare

(_____)
Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)
Shaqir Morina
Anëtar